

V E N D I M

Nr.687, datë 18.10.1998

PËR MASËN E SHPËRBLIMIT QË U JEPET SHTETASVE TË NDRYSHËM TË CILËT JAPIN INFORMACION PËR GRUMBULLIMIN E ARMËVE DHE TË MUNICIONEVE LUFTARAKE

Në mbështetje të nenit 13 të ligjit nr.8388, datë 5.8.199 “Për grumbullimin e armëve dhe të municioneve luftarake”, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Organet e policisë vlerësojnë e verifikojnë të dhënat për sasinë e armëve dhe të municioneve të fshehura që jepen nga burime të ndryshme informacioni.
2. Individët ose personat juridikë, që japin informacion të saktë për sasi të mëdha armësh dhe municionesh, shpërblehen në masën 5 për qind të sasisë së zbuluar, pas magazinimit të mallit.
3. Shpërblimi jepet nga drejtuesi i policisë së prefekturës ose i komisarariatit, në praninë e punonjësit të policisë, i cili ka marrë informacionin.
4. Informacioni për vendndodhjen e armëve dhe të municioneve përbën sekret shtetëror.
5. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga të ardhurat e Ministrisë së Rendit Publik, të realizuara nga shitja e mallrave kontrabandë, të konfiskuara sipas pikës 3/1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.593, datë 22.12.1997 “Për zbatimin e ligjit nr.8262, datë 15.12.1997 “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr.7599, datë 2.9.1992””, “Për Kodin Doganor”, ndryshuar me ligjin nr.8020, datë 1.11.1995, ndryshuar me dekretin nr.1578, datë 13.8.1996”, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.658, datë 18.10.1998.
6. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ministria e Rendit Publik të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko